



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 969/9 prot.

Datë 26.05.2025

V E N D I M

Nr. 701/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.05.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-40437-03-07-2025, me objekt: “Loti 2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore”, me fond limit 5,148,943.80 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.

Ankimues: BOE “O.E.S Distrimed” SHPK me NIPT K31520054N dhe “Euromed” SHPK me NIPT K71718012P dhe adresë Bulevardi “Bajram Curri”, pallati Kastrati, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës
Lagjia nr.7, Kukës

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK me NIPT L81512021D dhe adresë TIRANE, Rruga Don Bosko, Blloku Nr.1, Shkalla Nr.3, Kati I, Nr.4.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10-03-2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-40437-03-07-2025, me objekt: “Loti 2 Materiale

mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore”, me fond limit 5,148,943.80 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukes.

II.2. Në datën 20-03-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt – ankimi.

II.3. Në datën 04.04.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | | |
|--|---------------------------|-------------|
| 1. “Aquarius Medical” SHPK | 4,385,500 lekë pa tvsh | kualifikuar |
| 2. BOE “O.E.S Distrimed” shpk & “Euromed” shpk | 5,139,263.80 lekë pa tvsh | kualifikuar |

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik, më datë 09.04.2025, rezulton se është publikuar në SPE, Njoftimi i Fituesit Paraparak.

II.5. Në datën 14.04.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 969/2025 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5239 e BOE “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Euromed” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-40437-03-07-2025 me objekt “*Loti 2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore*” me fond limit: 5148943.0 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 2025-03-20 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukes. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Aquarius Medical SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 969/1 prot., datë 15.04.2025.

II.7. Me shkresën me nr. 969/2 prot., datë 24.04.2025, me lëndë “Dërgim vendimi”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 969/2 prot., datë 24.04.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar informacion mbi trajtimin e ankesës së BOE “O.E.S Distrimed” shpk dhe “Euromed” shpk nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.8. Me shkresën me nr. 969/3 prot., datë 07.05.2025 me lëndë “ Kërkesë për dorëzimin e mostrave” drejtuar autoritetit kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës dhe për dijeni operatorit ekonomik BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK dhe operatorit

ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar si vijon: “[...] kërkojmë nga ana juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë procesverbalin e dorëzimit të mostrave nga operatori ekonomik “Aquarius Medical ” SHPK, si dhe mostrën e dorëzuar nga ky i fundit për artikullin me nr. 38 Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis, artikullin me nr. 39 Sfungjer Nazal pa fill me tub ajrimi, artikullin me nr. 40 Sfungjer Nazal me fill, artikullin me nr. 70 Beze me vazeline, artikullin me nr. 151 Mesh e vogel, artikullin me nr. 152 Mesh e madhe së bashku me dokumentacionin shoqërues të saj”.

II.9. Me shkresën me nr. 1154 prot., datë 12.05.2025 protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 969/4 prot., datë 12.05.2025 me lëndë “Dërgim dokumentacioni dhe mostrave”, autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës ka dorëzuar: Procesverbal datë 20.03.2025 i marrjes në dorëzim të mostrave të njehsuar me origjinalin, listën e mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” shpk, mostrat për artikullin nr. 38 sfungjer nazal pa fill, epistaksis, artikullin me nr. 39 sfungjer nazal pa fill me tub ajrimi, artikullin nr. 40 sfungjer nazal me fill, artikullin nr. 70 bezë me vazelinë, artikullin me nr. 151 mesh e vogël, artikullin nr. 152 mesh e madhe.

II.10 Me shkresën me nr. 969/5 prot., datë 20.05.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion” drejtuar operatorit ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar si vijon: “[..]Referuar mostrave të dorëzuara nga autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 1154 prot., datë 12.05.2025, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 969/4 prot., datë 12.05.2025, Komisioni konstaton, se për Artikullin nr. 70 Beze me vazeline autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik si mostër artikullin Garza paraffinata, kompania prodhuese Farmac-Zabban, ndërkohë referuar shtojcës 2 “Lista e çmimeve të artikujve” të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Aquarius Medical ” SHPK operatori ekonomik ka deklaruar kompaninë prodhuese AD Medika VeSaglik Urunleri San.Ic.Ve.Dis.Ltd.Sti.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, kërkojmë nga ana juaj të konfirmoni mostrën e dorëzuar nga ana juaj për artikullin me nr. 70 Beze me vazeline.”.

II.11. Me shkresën me nr. 04 prot., datë 22.05.2025 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës tuaj nr. 969/5 prot., datë 20.05.2025”, operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK ka informuar si vijon: “[...] Konkretisht në lidhje me kërkesën tuaj për informacion për sa i përket mostrës për artikullin me nr. 70 “Bezë me vazelinë”, ju bëjmë me dije se nga ana jonë është dorëzuar pranë AK kjo mostër me origjinë dhe prodhues të njëjtë që kemi deklaruar edhe në shtojcën nr. 2 “Lista e çmimeve të artikujve”, pra me prodhues “AD Medikal VeSaglik Urunleri San IC. Ve. Dis. Ltd. Sti” me origjinë “Turqi”. Gjithashtu në SPE kemi dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kësaj kompanie prodhuese si: autorizim, CE, ISO, katalog. Etj”, si dhe ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik mostrën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë dorëzuar argumente nga subjektet e interesuara në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1 Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, (thema decidendum) në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës së paraqitur nga BOE “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Euromed” SHPK ndër të tjea ka lidhje me veprimet e tjera të autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Euromed” SHPK, se operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, nuk përmbush specifikimet teknike të lotit 2 të procedurës së sipërpërmendur e konkretisht: *“[...]kerkojme nga KSHA dhe KPP te kryhet verifikimi i mostrave te paraqitura nga OE “Aquarius Medical” duke u bazuar ne kerkesen e DST: Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 2). Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor të formularit te çmimit, e cila dorëzohet vetëm elektronikisht. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet. A jane paraqitur te gjitha mostrat e kerkuara dhe a evidentohet qarte origjina e mallit e cila duhet te perputhet me origjinen e deklaruar nga ofertuesi ne formularin e Ofertes dhe me Kataloget, Autorizimin e Prodhuesit dhe Certifikatat CE”, si dhe*

nisur nga pretendimi se: “[..]mbështetur në dispozitat e mësipërme ligjore, konstatojmë se procesi i administrimit të mostrave nuk është kryer konform dispozitave ligjore duke mos ofruar transparencë dhe integritet të procesit. AK nuk ka lejuar përfaqësuesin e BOE “O.E.S Distrimed” shpk dhe “Euromed” SHPK të jetë prezent gjatë administrimit të mostrave të OE “Aquarius Medical” SHPK dhe nuk na ka vënë në dispozicion procesverbalin e hartuar konform Udhëzimit të mësipërm ku duhej të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara, duke na hequr mundësinë që të bënim komente/pretendime në procesverbalin e mabjtur siç parashikon Udhëzimi i APP-së nr. 03, datë 12.04.2022”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2 Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në pikën 2.3.8 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2.3.8 Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Per te vertetuar qe OE i permbushin specifikimet teknike dhe jane ne gjendje te realizojne me sukses kontraten, duhet qe te paraqesin mostra per te gjithë artikujt, sipas tabelës ne specifikimet teknike dhe sipas katalogjeve perkatese te prodhuesit.

• OE ofertues duhet te paraqesin nga nje moster per cdo artikull.

Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit «Blerje materiale konsumi mjekesore e ndare ne dy lote: Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj » dhe jo para datës 20.03.2025 ora 12 :00.

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 2).
- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 2).

Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor të formularit te çmimit, e cila dorëzohet vetëm elektronikisht. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

III.1.3 Në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” për artikujt nr. 38, 39, 40, 70, 151, 152 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Specifikimi i Materialeve:

Loti 2 MM2 - Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore

Nr/List ën e MSHM SC	Artikulli	Specifikime teknike

38	<i>Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis</i>	<i>Me perberje polivinil acetat i hidrosilizuar, kompresim i dyfisht, pa fibra, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 10 cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2.5 cm</i>
39	<i>Sfungjer Nazal pa fill me tub ajrimi</i>	<i>Me perberje polivinil acetat i hidrosilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, trashesi 1.5 cm dhe lartesi 3 cm</i>
40	<i>Sfungjer Nazal me fill</i>	<i>Me perberje polivinil acetat i hidrosilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2 cm</i>
70	<i>Beze me vazeline</i>	<i>Beze me pomade te thjeshte (vazeline te bardhe, estere acid yndyror digliceroli te karbonateve dhe bikarbonateve, dyll sintetik) e pershkueshme nga ajri dhe eksudati, me shtrese te trashe qe nuk fshihet dhe ne rast te eksudatit masiv, jo alergjike, efektive dhe per trajtim afatgjate. 7.5cm x10 cm ose ekuivalent</i>
151	<i>Mesh e vogel</i>	<i>Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 150cm2</i>
152	<i>Mesh e madhe</i>	<i>Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 900cm2, porozitet > 75 mikron</i>

III.1.4. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës me nr. 1154 prot., datë 12.05.2025, protokolluar pranë KPP-së në datën 12.05.2025, konstatohet se bashkëlidhur këtij dokumentacioni është dorëzuar:

- 1- Procesverbal datë 20.03.2025 i marrjes në dorëzim të mostrave. Në këtë procesverbal konstatohet se operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar Mostrat për artikullin nr. 38 sfungjer nazal pa fill, epistaksis, artikullin me nr. 39 sfungjer

nazal pa fill me tub ajrimi, artikullin nr. 40 sfungjer nazal me fill, artikullin nr. 70 bezë me vazelinë, artikullin me nr. 151 mesh e vogël, artikullin nr. 152 mesh e madhe.

- 2- Shkresë “Lista e mostrave të dorëzuara” nënshkruar nga personi i autorizuar i shoqërisë “Aquarius Medical” shpk.
- 3- Mostrat për artikullin nr. 38 sfungjer nazal pa fill, epistaksis, artikullin me nr. 39 sfungjer nazal pa fill me tub ajrimi, artikullin nr. 40 sfungjer nazal me fill, artikullin nr. 70 bezë me vazelinë, artikullin me nr. 151 mesh e vogël, artikullin nr. 152 mesh e madhe.

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.6. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.7. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si*

pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.1.8. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.9. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. 38 Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose [...]”;

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. KPP konstaton, se duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, një nga pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Euromed” SHPK ka të bëjë përkatësisht me mospërmbushjen e specifikimeve teknike

të lotit 2 të procedurës së prokurimit objekt-ankimi nga ana e operatorit ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, e konkretisht të mostrave me nr. 38- Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis, nr. 39- Sfungjer Nazal pa fill me tub ajrimi, nr. 40- Sfungjer Nazal me fill, nr. 70- Beze me vazeline, nr. 151- Mesh e vogel, nr. 152- Mesh e madhe, si dhe me procesin e administrimit të mostrave, si dhe procesin e administrimit të mostrave.

III.1.11. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, për një verifikim të thelluar të çështjes me shkresën me nr. 969/3 prot., datë 07.05.2025 me lëndë “Kërkesë për dorëzimin e mostrave” drejtuar autoritetit kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës dhe për dijeni BOE “O.E.S DISTRIMED” SHPK & “EUROMED” SHPK dhe operatorit ekonomik “AQUARIUS MEDICAL” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar si vijon: “[..] kërkojmë nga ana juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë procesverbalin e dorëzimit të mostrave nga operatori ekonomik “Aquarius Medical ” SHPK, si dhe mostrën e dorëzuar nga ky i fundit për artikullin me nr. 38 Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis, artikullin me nr. 39 Sfungjer Nazal pa fill me tub ajrimi, artikullin me nr. 40 Sfungjer Nazal me fill, artikullin me nr. 70 Beze me vazeline, artikullin me nr. 151 Mesh e vogel, artikullin me nr. 152 Mesh e madhe së bashku me dokumentacionin shoqërues të saj”.

III.1.12. Me shkresën me nr. 1154 prot., datë 12.05.2025 protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 969/4 prot., datë 12.05.2025 me lëndë “Dërgim dokumentacioni dhe mostrave”, autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës ka dorëzuar: Procesverbal datë 20.03.2025 i marrjes në dorëzim të mostrave të njehsuar me origjinalin, listën e mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” shpk, mostrat për artikullin nr. 38 sfungjer nazal pa fill, epistaksis, artikullin me nr. 39 sfungjer nazal pa fill me tub ajrimi, artikullin nr. 40 sfungjer nazal me fill, artikullin nr. 70 bezë me vazelinë, artikullin me nr. 151 mesh e vogël, artikullin nr. 152 mesh e madhe.

Referuar dokumentacionit të sipërpërmendur, KPP konstaton se me shkresën me nr. 1154 prot., datë 12.05.2025 autoriteti kontraktor ka dorëzuar procesverbalin e marrjes në dorëzim të mostrave “Procesverbal vlerësimi të mostrave” me nr. 789 prot., datë 20.03.2025”, i firmosur nga Komisioni i vlerësimit të Ofertave dhe përfaqësuesi i operatorit ekonomik “Aquarius Medical” SHPK. Referuar procesverbalit të dorëzuar KPP konstaton, se operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar mostrat për artikullin nr. 38 sfungjer nazal pa fill, epistaksis, me Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, pa fibra, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 10 cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2.5 cm, për artikullin nr. 39 Sfungjer Nazal pa fill me tub ajrimi, Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, trashesi 1.5 cm dhe lartesi 3 cm, për artikullin nr. Sfungjer Nazal me fill, Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2 cm, për artikullin nr. 151 Mesh e vogel, Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 150cm2, për artikullin nr. 152 Mesh e madhe, Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen

dhe PGA dhe kopolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 900cm2, porozitet > 75 mikron.

Nga verifikimi i mostrave të operatorit ekonomik “Aquarius Medical” SHPK të dorëzuara nga autoriteti kontraktor, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK për artikullin nr. 38 Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis, ka dorëzuar si mostër artikullin anatomik Nazal Tampon, kompania prodhuese AD Medical Saglik URUNLERI SAN.IÇ VE DIS TIC. LTD.STI, ku nga verifikimi konstatohet se është e ambalazhuar dhe mbi ambalazh konstatohet se përmban shënimin CE, si dhe përmasat e produktit 8,0x3,0x1,5 cm.

Artikullin nr. 39 Sfungjer Nazal pa fill me tub ajrimi ka dorëzuar si mostër artikullin Nazal Tampon Hortumlu ku nga verifikimi konstatohet se është e ambalazhuar dhe mbi ambalazh nuk evidentohet shënimi CE. Ndërkohë evidentohen përmasat e produktit 8,0x2,0x1,5 cm.

Artikullin nr. 40 Sfungjer Nazal me fill, ka dorëzuar si mostër artikullin Nazal Tampon ku nga verifikimi konstatohet se është e ambalazhuar dhe mbi ambalazh evidentohet shënimi CE, si dhe evidentohen përmasat e produktit 8,0x2,0x1,5 cm. Artikullin nr. 70 Beze me vazeline ka dorëzuar si mostër artikullin Garza paraffinata, kompania prodhuese Farmac-Zabban, ku nga verifikimi konstatohet se është e ambalazhuar dhe mbi ambalazh evidentohet shënimi CE, si dhe specifikimet teknike si përmasat 10*10. Artikullin nr. 151, Mesh e vogel ka dorëzuar si mostër artikullin Polymesh composite, pjesërisht e absorbueshme kompania prodhuese Betatech Medikal Cihazlar San. Mum. IÇ ve Dis Tic.LTD.Sti e ambalazhuar ku mbi ambalazh evidentohet markimi CE, si dhe evidentohen përmasat 10 * 15 cm. Artikullin nr. 152, Mesh e madhe ka dorëzuar si mostër artikullin Polymesh composite, pjesërisht e absorbueshme kompania prodhuese Betatech Medikal Cihazlar San. Mum. IÇ ve Dis Tic.LTD.Sti e ambalazhuar ku mbi ambalazh evidentohet markimi CE, si dhe evidentohen përmasat 30 * 30 cm. Ndërkohë referuar shtojcës 2 “Lista e çmimeve të artikujve” të dorëzuar nga operatori ekonomik në SPE Komisioni konstaton se, për artikullin nr. 38 Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis ka deklaruar kompani prodhuese AD Medical Saglik URUNLERI SAN.IÇ VE DIS TIC. LTD.STI, Turqi, Artikullin nr. 39 Sfungjer Nazal pa fill me tub ajrimi ka deklaruar kompani prodhuese AD Medical Saglik URUNLERI SAN.IÇ VE DIS TIC. LTD.STI, Turqi, Artikullin nr. 40 Sfungjer Nazal me fill ka deklaruar kompani prodhuese AD Medical Saglik URUNLERI SAN.IÇ VE DIS TIC. LTD.STI, Turqi, për artikullin nr. 70 Beze me vazeline ka deklaruar kompani prodhuese AD Medical Saglik URUNLERI SAN.IÇ VE DIS TIC. LTD.STI, për artikullin nr. 151 mesh e vogël ka deklaruar kompani prodhuese Betatech Medikal, për artikullin nr. 152 mesh e madhe ka deklaruar kompani prodhuese Betatech Medikal.

Akoma më tej nisur nga verifikimi i kryer, referuar specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për artikujt e mësipërm, si dhe nga verifikimi i përmbushjes së këtyre specifikimeve në artikujt e paraqitur për mostër nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, si dhe referuar shtojcës 2 “Lista e çmimeve të artikujve” të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik Komisioni, konstaton se ndër të tjera për artikullin nr. 70 nuk përputhet kompania prodhuese e deklaruar nga operatori ekonomik në shtojcën 2 me kompaninë prodhuese që rezulton mbi ambalazhin e mostrës së dorëzuar pranë KPP-së nga autoriteti kontraktor.

Për një hetim sa më transparent me shkresën me nr. 969/5 prot., datë 20.05.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion” drejtuar operatorit ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar si vijon: “[...] Referuar mostrave të dorëzuara nga autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 1154 prot., datë 12.05.2025, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 969/4 prot., datë 12.05.2025, Komisioni konstaton, se për Artikullin nr. 70 Beze me vazeline autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik si mostër artikullin Garza paraffinata, kompania prodhuese Farmac-Zabban, ndërkohë referuar shtojcës 2 “Lista e çmimeve të artikujve” të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Aquarius Medical ” SHPK operatori ekonomik ka deklaruar kompaninë prodhuese AD Medika VeSaglik Urunleri San.Ic.Ve.Dis.Ltd.Sti.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, kërkojmë nga ana juaj të konfirmoni mostrën e dorëzuar nga ana juaj për artikullin me nr. 70 Beze me vazeline. Me shkresën me nr. 04 prot., datë 22.05.2025 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës tuaj nr. 969/5 prot., datë 20.05.2025”, operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK ka informuar si vijon: “[...] Konkretisht në lidhje me kërkesën tuaj për informacion për sa i përket mostrës për artikullin me nr. 70 “Bezë me vazelinë”, ju bëjmë me dije se nga ana jonë është dorëzuar pranë AK kjo mostër me origjinë dhe prodhues të njëjtë që kemi deklaruar edhe në shtojcën nr. 2 “Lista e çmimeve të artikujve”, pra me prodhues “AD Medikal VeSaglik Urunleri San IC. Ve. Dis. Ltd. Sti” me origjinë “Turqi”. Gjithashtu në SPE kemi dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kësaj kompanie prodhuese si: autorizim, CE, ISO, katalog. Etj”si dhe ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik mostrën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor. Nërkohë referuar shkresës së dorëzuar nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK bashkëlidhur shkresës ka dorëzuar edhe mostrën Soluble Hemostatic Gauze me prodhues AD Medikal VeSaglik Urunleri San IC. Ve. Dis. Ltd. Sti” me origjinë “Turqi”.

Akoma më tej referuar procesverbalit të vlerësimit të mostrave të mbajtur ndërmjet Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 789 prot., datë 20.03.2025, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën me nr. 1154 prot., datë 12.05.2025, KPP konstaton se në procesverbalin e mbajtur KVO ka listuar artikujt e dorëzuar nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, por duke mos dokumentuar specifikimet teknike konkrete të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik. Referuar Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, Udhëzim nr. 03, datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë” në pikën 3 përcaktohet shprehimisht: “3. Për të dokumentuar procesin e administrimit të mostrave, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të këtij procesi.

Në këtë kuptim, në rastin kur autoriteti/enti kontraktor vlerëson si të nevojshëm dorëzimin e mostrave në datën dhe orën e përcaktuar në dokumentet e tenderit për paraqitjen e tyre nga ofertuesit, duhet të mbajë një procesverbal. Procesverbali duhet të dokumentojë procesin e

paraqitjes së mostrave, si dhe duhet të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara.

Në këtë rast, mbajtja e procesverbaleve i shërben vetëm procesit të paraqitjes së mostrave, deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesit. Procesverbali i mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishëm, i cili duhet të nëshkruhet nga të dyja palët (përfaqësuesi/it i autoritetit/entit kontraktor dhe i ofertuesit/ve), duhet ti vihet në dispozicion ofertuesit/ve.

Në rast se, ndonjëra nga palët ka komente/pretendime, ato duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur”, si dhe referuar mostrave të dorëzuara nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe referuar procesverbalit të vlerësimit të mostrave të mbajtur ndërmjet Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 789 prot., datë 20.03.2025 dhe operatorit ekonomik “Aquarius Medical” SHPK Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka pasqyruar detaje që të përshkruajnë konkretisht mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK. Akoma më tej ndodhur në kushtet kur për Artikullin nr. 70 Beze me vazeline autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik si mostër artikullin Garza paraffinata, kompania prodhuese Farmac-Zabban, ndërkohë referuar shtojcës 2 “Lista e çmimeve të artikujve” të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK operatori ekonomik ka deklaruar kompaninë prodhuese AD Medika VeSaglik Urunleri San.Ic.Ve.Dis.Ltd.Sti, si dhe referuar shkresës me nr. 04 prot., datë 22.05.2025 të dorëzuar pranë KPP-së nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK ka dorëzuar mostrën me prodhues AD Medika VeSaglik Urunleri San.Ic.Ve.Dis.Ltd.Sti. KPP konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka treguar kujdesin e duhur në lidhje me ruajtjen dhe administrimin e mostrave pasi referuar mostrës me nr. 70 bezë me vazelinë mostra e dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe mostra e dorëzuar nga operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK nuk është e njëjtë. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.1.13. Sa më sipër, mungesa e transparencës lidhur me hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor, për sa i përket verifikimit të mostrave (pasi në asnjë rast nuk vërtetohen me dokumentacion provues veprimet e kryera) shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit, dhe krijon hapësirë për vlerësim subjektiv.

KPP nënvizon, se në respekt të parimit të transparencës, mosdiskriminimit dhe barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve, jo vetëm kriteret e kualifikimit, por edhe procedurat verifikuese të ndjekura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mirëpërcaktuara nga autoriteti kontraktor, me qëllim që të jenë sa më të kuptueshme dhe transparente, jo vetëm për operatorët ekonomikë të interesuar për të qenë pjesëmarrës, por edhe për komisionin e vlerësimit të ofertave dhe komisionin e shqyrtimit të ankesave në mënyrë të tillë,

që procesi i vlerësimit të kryhet në trsansparencë të plotë dhe jo me subjektivizëm; si dhe të vendosë në situatë të barabartë të gjithë ofertuesit, duke rritur besimin e subjekteve në një procedurë prokurimi. KPP sqaron se ndër qëllimet kryesore të ligjit të prokurimit publik është edhe ai i sigurimit të integritetit, besimit të publikut dhe transparencës në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

III.1.14. Në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji përcaktohet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”. Në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se procesi i administrimit, trajtimit dhe verifikimit të mostrave është bërë jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, pasi mungojnë dy elemente të rëndësishme, transparenca dhe provueshmëria, ndaj, përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Euromed” SHPK, mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Aquarius Medical” SHPK, gjykojmë, se referuar arsyetimit të mësipërm, procedura e prokurimit do të anulohet, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e

Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e 11 Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Euromed” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-40437-03-07-2025, me objekt: “Loti 2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevojat spitalore”, me fond limit 5,148,943.80 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukes.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit dhe me rihapjen e saj të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Euromed” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

